

PERSPEKTIVA KREDIBILE PËR ZGJERIM DHE ANGAZHIMI I PËRFORCUAR I BE-SË ME BALLKANIN PERËNDIMOR

Në fjalimin e tij për gjendjen e Bashkimit Evropian në vitin 2017, Kryetari i Komisionit Evropian, Zhan Klod Junker, e vërtetoi ardhmërinë evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor:

„Nëse duam stabilitet më të madh në fqinjësinë tonë, atëherë duhet të mbajmë perspektivë kredibile për zgjerim për Ballkanin Perëndimor. Është e qartë se nuk do të ketë zgjerim të mëtejshëm gjatë kohës së këtij komisioni dhe këtij kuvendi. Asnjë kandidat nuk është i përgatitur. Por, pas kësaj Bashkimi Evropian do të numërojë më tepër se 27 vende anëtare. Kandidatët për qasjen në negociatat duhet t'i japin prioritet të madh sundimit të së drejtës, drejtësisë dhe të drejtave fundamentale.”

Shifat e shteteve apo qeverive në BE vazhdimisht e mbështetën rrugën evropiane të rajonit, herën e fundit në konkluzionet e Kryetarit të Këshillit Evropian në mars 2017:

„Këshilli Evropian [...] e vërtetoi mbështetjen e tij të parzërvë për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor. Duke e përshëndetur përparimin nga ana e vendeve në rajon, Këshilli Evropian thekson se BE-ja mbetet e përkushtuar dhe e angazhuar në të gjitha nivelet që t'i mbështesë në zbatimin e reformave dhe projekteve lidhur me BE-në“.

Ballkani Perëndimor është **pjesë e Evropës**, gjeografikisht e rrethuar me vendet-anëtare të BE-së. Popujt e BE-së dhe të rajonit kanë trashëgimi të përbashkët dhe histori e ardhmëri të përkufizuar me mundësitë dhe sfidat e përbashkëta. BE-ja një kohë të gjatë është në masë të madhe e angazhuar në rajonin. Nga Këshilli Evropian në Selanik në vitin 2003, ajo e mbështet ardhmërinë e rajonit si pjesë integrale të BE-së.

Prej atëherë perspektiva evropiane e rajonit u ndihmoi vendeve të arrijnë reforma të përgjithshme politike dhe ekonomike me proceset e përmirësuara demokratike. Liberalizimi i vizave dhe bashkëpunimi i përmirësuar rajonal nxisin shoqëri më transparente. Në vitin 2016, shkëmbimi i përgjithshëm tregtar i rajonit me BE-në ishte mbi 43 miliardë euro, i rritur për 80% nga viti 2008 dhe me potencialin evident për rritjen e mëtejshme. Kompanitë e BE-së janë, gjithashtu, investues të mëdhenj në Ballkanin Perëndimor me mbi 10 miliardë euro të investimeve të drejtpërdrejta të huaja në rajon vetëm në pesë vitet e kaluara. Lidhshmëria e ndërsjellë dhe varshmëria e ndërsjellë e rajonit me Bashkimin Evropian ishte evidente gjatë kohës së krizës së migracionit. Vendet e rajonit gjithnjë e më tepër veprojnë si partnerë në skenën globale.

Kjo perspektivë e fuqishme, e bazuar në meritat, për anëtarësimin në BE të Ballkanit Perëndimor është në **interes politik, të sigurisë dhe interes ekonomik të Bashkimit Evropian**. Ky është investim gjeostrategjik në Evropën stabile, të fuqishme dhe të bashkuar të bazuar në **vlerat e përbashkëta**. Kjo është vegël e fuqishme për përparimin e demokracisë, sundimin e së drejtës dhe respektimin e të drejtave fundamentale. Perspektiva kredibile për aderim është **shtytësi kryesor i transformimit** në rajon dhe me këtë e përforcon integrimin tonë kolektiv, sigurinë, prosperitetin dhe mirëqenien sociale. Edhe më tutje është me rëndësi esenciale për nxitjen e pajtimit dhe stabilitetit.

Përveç kësaj, politika e zgjerimit të BE-së duhet të jetë pjesë e strategjisë së madhe për përforcimin e Bashkimit Evropian deri në vitin 2025 e lajmëruar nga Kryetari Junker në fjalimin e tij për gjendjen e Bashkimit Evropian në shtator 2017. Ky është **investim në**

sigurinë, rritjen ekonomike dhe ndikimin e BE-së dhe në aftësinë e saj t'i mbrojë qytetarët e saj.

Bashkimi Evropian duhet të jetë më i fuqishëm dhe më stabil para se të bëhet më i madh. Pikërisht për këtë shkak në pajtim me Udhërrëfyesin për Bashkimin Evropian të bashkuar, të fuqishëm dhe demokratik¹, Komisioni gjatë këtij viti do të propozojë disa iniciativa në drejtim të përmirësimit të kornizës demokratike dhe institucionale dhe kornizës së politikave për Bashkimin Evropian në vitin 2025 në bazë të marrëveshjeve rrjedhëse. Konkretisht këto iniciativa do të përfshijnë propozime për përmirësimin e efektivitetit në miratimin e vendimeve në kornizat e BE-së me përfundimin e votimit me shumicën e kualifikuar në sferat si politika e jashtme apo çështjet nga sfera e tregut të brendshëm.

Deri në këtë datë, BE-ja mund të jetë më i madh se 27 vende-anëtare. Negociatat për aderim me Malin e Zi dhe Serbinë janë në rrjedhë një kohë të gjatë. Me dëshirë të fuqishme politike, dërgimi i reformave reale dhe të qëndrueshme dhe zgjidhjeve përfundimtare të kontesteve ndërmjet fqinjve, këto potencialisht do të mund të përgatiten për anëtarësim në perspektivën deri në vitin 2025. Kjo perspektivë është ekstremisht ambicioze. Nëse do të arrihet do të varet plotësisht nga meritat dhe rezultatet objektive të secilit vend.

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor tani duhet urgjentisht t'i dyfishoj përpjekjet e tyre, të marrin reforma vitale dhe ta përfundojnë transformimin e tyre politik, ekonomik dhe social, duke i përfshirë të gjitha palët e prekura nga spektri politik dhe nga shoqëria civile. Aderimi në BE është shumë më tepër se një proces teknik. Kjo është zgjedhje gjeneratash, e bazuar në vlerat fundamentale, të cilat secili vend duhet t'i pranojë në mënyrë aktive, duke filluar nga politikat e tyre të jashtme dhe rajonale dhe deri tek ajo që fëmijët e mësojnë në shkolla.

Vendet e Ballkanit Perëndimor tani kanë **dritare historike të mundësisë** që fuqishëm dhe pazezervë ta lidhin ardhmërinë e vet me Bashkimin Evropian. Duhet të veprojnë me vendosmëri. Aderimi është dhe do të mbetet proces i bazuar në meritat që plotësisht varet nga përparimi objektiv i arritur nga secili vend. Vendet duhet të barazohen në arritjet apo të tejkalohen njëri me tjetrin në varësi nga përparimi i arritur.

Komisioni është i gatshëm të përgatisë rekomandime për hapjen e negociatave aderuese me Shqipërinë dhe Republikën e Maqedonisë, në bazë të kushteve të përmbushura. Me përpjekjen dhe angazhimin e vazhdueshëm, Bosnjë e Hercegovina mund të jetë kandidatë për aderim. Kosova* ka mundësi për përparim të qëndrueshëm përmes zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim dhe të përparojë në rrugën evropiane pasi të lejojnë rrethanat objektive.

Jeta e përditshme e Ballkanit Perëndimor duhet gradualisht të afrohet me jetën në Bashkimin Evropian. Në qëllimin final, qytetarët synojnë të jetojnë në vendet që kanë prosperitet dhe janë të barabarta, ku sundimi i së drejtës është i fuqishëm dhe korrupsioni është i çrrenjosur. Kjo strategji përkufizon se si me mëshitetjen e rritur nga BE-ja, duke e përfshirë përmes pjesëmarrjes në politikat dhe programet e caktuara të Bashkimit Evropian, vendet e Ballkanit Perëndimor të mund të kenë dobi nga stabiliteti dhe prosperiteti i rritur që për kthim do të lehtësohet përparimi i rrugës së tyre evropiane.

I. PERSPEKTIVA KREDIBILE PËR ZGJERIM KËRKON PËRPJEKJE DHE

¹ https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/roadmap-factsheet-tallinn_en.pdf

* Kjo shenjë është pa paragjykimë në lidhje me pozicionet për statusin dhe është në pajtim me UNHCR 1244/1999 dhe Mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën për pavarësinë e Kosovës.

REFORMA KREDIBILE NË BALLKANIN PERËNDIMOR²

Vendet e Ballkanit Perëndimor **do të mund t'i bashkohen Bashkimit Evropian** pasi do t'i përmbushin kriteret nga neni 49 i Marrëveshjes për Bashkimin Evropian, duke i përfshirë Kriteret e Kopenhagës. Edhe pse **as një vend nuk i përmbush këto kritere sot**, rajoni kakaluar një rrugë të gjatë nga fundi i viteve të nëntëdhjeta. Në përgjithësi, është bërë një përparim evident edhe te reformat dhe në tejkalimin e trashëgimisë destruktive të luftrave dhe konflikteve. Por, që vendet **t'i përmbushin të gjitha kushtet për anëtarësim dhe t'i përforcojnë demokracitë e tyre, nevojiten reforma gjithëpërfshirëse dhe të bindshme në sferat kryesore**, veçanërisht në sferat e sundimit të së drejtës, konkurrencës dhe bashkëpunimit rajon dhe pajtimit.

E para, **sundimi i së drejtës** duhet të përforcohet. Sot shtetet tregojnë elemente të qarta të shtetit të robëruar, duke e përfshirë lidhshmërinë me krimin e organizuar dhe korrupsionin në të gjitha nivelet e pushtetit dhe menaxhimit, si dhe ndërlidhje të fuqishme të interesave publike dhe private. Tërë kjo krijon ndjenjën e mosdënimit dhe pabarazisë. Ka përzierje dhe kontroll të madh politik në mediet. Dukshëm është përforcuar dhe është bërë e pavarur gjyqësia dhe qeveritë raportuese dhe administratat janë me rëndësi esenciale që të jepet kontribut në ndryshimin e përhershëm shoqëror i cili është i domosdoshëm.

E dyta, pjesët kritike të **ekonomive të rajonit** janë jokonkurrencte me përzierjen e tepër dhe të panevojshme politike dhe me sektorin privat të zhvilluar në mënyrë të pamjaftueshme. Asnjë nga ekonomitë në Ballkanin Perëndimor në këtë moment nuk mund të konsiderohet ekonomi funksionale e tregut, e as të konsiderohet se ka kapacitet që të ballafaqohet me presionin e konkurrencës dhe fuqitë e tregut në Bashkimin Evropian. Edhe krahas tërë përparimit në reformat, mbesin shumë çështje strukturore që ndikojnë në tregjet e punës dhe veçanërisht në mundësitë për punësimin e të rinjve.

E treta, ende ka **konteste të rëndësishme bilaterale** ndërmjet vendeve në rajon që duhet të zgjidhen. BE-ja nuk do të pranojë t'i importojë këto konteste dhe jostabilitetin i cili mund të pasojë pas tyre. Duhet të gjenden zgjidhjet përfundimtare dhe obliguese dhe këto të zbatohen para se vendi të aderohet.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, **aderimi në BE është zgjidhje**. Nevojitet konsensus politik dhe shoqëror dhe mbështetje nga populli. Nuk duhet të ketë dyshim te liderët për atë ku bie Ballkani Perëndimor dhe për drejtimin në të cilën udhëzohen. Kjo është e domosdoshme që të sigurohet dhe të mbahet mbështetja nga qytetarët e tyre dhe nga qytetarët e BE-së dhe duhet të pasqyrohet në komunikimin e liderëve me qytetarët.

Rruga evropiane e secilit vend të Ballkanit Perëndimor është mbështetur me iniciativa të ndryshme, si Procesi i Berlinit², platformat sektoriale si komuniteti energjetik dhe transportues dhe aktorët rajonalë, siç është Këshilli për Bashkëpunimin Rajonal.

Tani varet nga pushtetet e shteteve, me mbështetjen e shoqërive të tyre, ta marrin pronësinë dhe të dërgojnë në lidhje me kushtet mirë të njohura për aderim. Për skenarin ambicioz në rastin më të mirë të bëhet realitet, **duhet të merret veprimi tani**. Në fund, qytetarët e rajonit do t'u gjykojnë qeverive të tyre për atë nëse këta kanë dëshirë dhe janë të aftë të dërgojnë në lidhje me ambiciet e tyre evropiane.

² Komisioni do ta miratojë komunikimin gjinor për politikën e zgjerimit të BE-së së bashku me raportet gjithëpërfshirëse për vendet në prill 2018.

² Samiti i fundit për procesin ishte në Tërst në korrik 2017.

1. Sundimi i së drejtës, të drejtat fundamentale, menaxhimi

T'u përgjigjet reformave në sferën e **sundimit të së drejtës, të drejtave fundamentale dhe menaxhimit të mirë** edhe më tutje mbetet çështja më urgjente për Ballkanin Perëndimor. Ky është edhe përcaktuesi kryesor në bazë të të cilit BE-ja do të vendos për perspektivat e këtyre vendeve. Rajoni duhet t'i pranojë këto vlera fundamentale fuqishëm dhe me kredibilitet. Mosrespektimi i tyre i kthen institucionet dhe tregtinë. Përforcimi i sundimit të së drejtës nuk është vetëm çështje institucionale. Ky kërkon edhe transformim shoqëror.

Duhet të sigurohet **pavarësia, cilësia dhe efikasiteti i sistemit gjyqësor**. Pavarësia e gjyqësisë dhe gjykatësve individualë është kryesore që të sigurohet drejtësia dhe të kërkoet përgjegjësia e pushtetit ekzekutiv dhe ligjvënës. Ky është parakusht për secilën shoqëri demokratike të bazuar në sundimin e së drejtës dhe për zhvillimin e tij ekonomik.

Vendet duhet ta çrrënjosin **korrupsionin** pa kompromis. Institucionet e fuqishme dhe të pavarura janë kryesore për parandalimin dhe ballafaqimin me korrupsionin dhe për zbatimin e hetimeve dhe akuzave efikase që do të shpjen në **aktgjykimet** gjyqësore përfundimtare të cilat do të kryhen, dhe do të përfshijnë **sanksione me veprim kthyes**. Strukturat e specializuara të prokurorit për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe trupat gjyqësore duhet të përforcohen. Kjo duhet të përfshijë ndarjen e njërive policore speciale në prokuroritë. Duhet të ndiqen dhe zbatohen masat si marrja e pronës së fituar në mënyrë joligjore, humbja e së drejtës të kihet funksion publik, rregulla më të rrepta në të cilat do të mbështeten funksionarët publikë dhe informatat dhe mekanizmat e arritshme për paditë për qytetarët.

Vendet duhet të vendosin edhe kornizë të fuqishme për parandalimin e korrupsionit. Nevojitet transparencë e madhe për menaxhimin me financat publike, veçanërisht në të gjitha fazat e **furnizimit publik**, sfera e cila i është nënshtruar korrupsionit. Kishte disa shembuj në Ballkanin Perëndimor për procedurat e besueshme për furnizimin e mallrave dhe janë dhënë marrëveshje të mëdha pa tender publik. Kishte konstatime për nënrealizuesit lokalë të lidhur politikë që janë favorizuar edhe për pagesat joligjore. Vendet duhet ta rrisin transparencën, konkurrencën dhe drejtësinë e tenderëve për furnizimet publike, ta kufizojnë përdorimin e procedurave të besueshme dhe të fusin masa mbrojtëse që do të përjashtojnë ndikim politik tek ofruesit. Duhet plotësisht të zhvillohet përdorimi i transparencës, publikisht është i arritshëm **e-furnizimi**. Kjo duhet t'u mundësojë qytetarëve të shohin qartë se si shpenzohen tatimet e tyre, nga tenderi fillestar deri në realizimin e fundit të marrëveshjeve. Përgjegjësia e udhëheqësisë dhe kulturës së kontrollit të brendshëm në institucionet publike janë, gjithashtu, kryesore.

Çrrënjësja e krimin të organizuar në Ballkanin Perëndimor edhe më tutje është e fuqishme pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për tregtinë me njerëz, drogën dhe armën apo për rrezikun nga infiltrimi kriminal në sistemet politike dhe ekonomike. Pushtetet duhet në mënyrë efikase **t'i shkatërrojnë rrjetet kriminale dhe bazat e tyre ekonomike**, sistematikisht duke i shfrytëzuar hetimet financiare dhe duke i zbatuar **veprat** e targetuara siç janë: bllokimi i redimenteve nga veprat ndëshkuese për shkak të kujdesit, konfiskimi i palës së tretë, barra mbi të akuzuarin për dëshmimin në lidhje me mbajtjen e llojeve të caktuara të pronës, konfiskimi pa gjykim për shkak të ballafaqimit me pasurinë pa mbulesë, kërkesat për publikimin e pronësisë së plotë të kompanive dhe përforcimi i bashkëpunimit gjyqësor. Si çështje urgjente duhet të vendoset **evidenca konkrete dhe e qëndrueshme për ballafaqimin me korrupsionin, pastrimin e parave dhe krimin e organizuar**.

Të drejtat fundamentale janë në masë të madhe të përfshira me ligjvënien e vendeve të Ballkanit Perëndimor, por duhet të bëhet më tepër që të sigurohet se këto janë plotësisht të

zbatuara në praktikë. Nevojitet fokusi konkret që të mbrohet liria e shprehjes dhe pavarësisë së medieve si shtyllë e demokracisë. Nevojiten përpjekje vendimtare që të mbrohet komuniteti joshumicë dhe për luftën kundër diskriminimit, veçanërisht për romët – për të cilët inkluzioni social duhet të përmirësohet në mënyrë të vendosur – dhe komuniteti LGBTI. Duhet të garantohet edhe barazia ndërmjet femrave dhe meshkujve dhe të merren aktivitetet për ballafaqimin me dhunën në familje.

Me rëndësi esenciale është të përfordhet funksionimi i **institucioneve demokratike**. Kjo përfshinë sigurimin e dialogut konstruktiv nëpër spektrin politik, veçanërisht në kornizat e **kuvendeve**. Qeveria duhet të sigurojë se opozitës plotësisht do t'i mundësohet ta kryejë rolin e vet. Opozita duhet në mënyrë konstruktive të përfshirhet në procesin demokratik. Zgjedhjet duhet të jenë të lira dhe të drejta, kurse rekomandimet e misioneve për mbikëqyrjen e zgjedhjeve që në mënyrë përkatëse të zbatohen. Rregullat për **financimin publik dhe privat të partive politike** gjithashtu kërkojnë reforma evidente.

Reforma e administratës publike është më e rëndësishme për përfordimin e menaxhimit në të gjitha nivelet. Kjo përfshinë përmirësimin e cilësisë dhe raportimit të administratës, rritjen e profesionalizmit, depolitizimit dhe transparencës, njëjtë edhe gjatë punësimit edhe të lëshimit, menaxhimin transparent të financave publike dhe shërbimet e mira për qytetarët. Gjithashtu, duhet të gjendet bilanci përkatës ndërmjet pushtetit qendror, rajonal dhe lokal.

Qeveritë duhet të garantojnë se palët e prekura do të mundin në mënyrë aktive të marrin pjesë në reformat dhe në procesin e krijimit të politikave, qeveritë duhet të garantojnë se palët e prekura do të mundin në mënyrë aktive të marrin pjesë në reformat dhe në procesin e krijimit të politikave, për shembull, me vendosjen e **dialogjeve të strukturuarra inkluzive për prioritetet reformuese** me përfshirjen e shoqërisë së përforduar civile. Si rrjedhojë, me rëndësi esenciale është mjedisi që mundësohet për organizatat civile.

Të gjitha këto reforma edhe më tutje janë në bërthamën e rrugës në rajonin e BE-së. Vetëm me dërgimin e rezultateve evidente dhe të qëndrueshme do të arrihet monumenti i domosdoshëm kredibil.

2. Përfordimi i ekonomisë

Ballkani Perëndimor ka **potencial ekonomik** evident. Shkallët e rritjes janë më të larta se ato të BE-së dhe është gjithnjë treg më interesant për mallrat dhe shërbimet e BE-së që gradualisht bëhet pjesë e zinxhirëve të vlefshëm evropianë. Niveli i integritit ekonomik me Bashkimin Evropian është shumë i lartë si rezultat i marrëveshjeve për stabilizim dhe asocim.

Nevojiten **përpjekje të mëtutjeshme** që të rritet konkurrenca e ekonomive të Ballkanit Perëndimor, të adresohet papunësia e madhe, veçanërisht ndërmjet të rinjve, të rritet prosperiteti dhe të krijohen mundësitë për biznes, duke përfshirë edhe për lojtarët lokalë. Ekonomitë e fuqishme të bazuara në shkathësi, gjithashtu, do të ndihmojnë dhe do të zvogëlohet ikja e intelektualëve që ekziston, duke e shndërruar në qarkullimin e tyre. Modernizimi i mëtejshëm i ekonomive rajonale për kthim do të tërheq investime private shtesë të BE-së dhe do ta rrit kërkesën për mallra dhe shërbime të BE-së në Ballkanin Perëndimor. Reformat e domosdoshme strukturore duhet të mbështeten nga politikat ekonomike dhe fiskale përkatëse.

Ekonomitë e rajonit ballafaqohen me shumë **dobësi strukturore**, me tregjet joefikase dhe jofleksibile, produktivitet i ulët, qasje të kufizuar në financim, të drejtat e paqarta personale dhe mjedisi i madh rregullator që shpie në konkurrencën e dobët dhe papunësinë e lartë. Në

përgjithësi, shkallët e investimit dhe rritjes nuk janë të mjaftueshme të zvogëlohet nyja me BE-në. Zhvillimi ekonomik është pengesë shtesë edhe nga çrrënjësia e ekonomisë joformale. Përfshirja e shtetit dhe përzierja e panevojshme politike në ekonomi edhe më tutje janë të larta, kurse politika e konkurrencës dhe politikat tjera anësore ende janë shumë të dobëta. Reformat strukturore të koncipuara në programet për reformën ekonomike duhet të zbatohen me rrigorozitet të madh. Masat për ballafaqimin me sfidat sociale dhe papunësinë strukturore duhet të jenë prioritare. Proceset e privatizimit duhet të përparojnë deri në transparencën e plotë. Ndërmarrjet në pronësinë shtetërore duhet të reformohen si prioritete dhe duhet të ketë ballafaqim me korrupsionin. Potenciali për rritjen dhe konkurrencën vazhdojnë të pengohen nga dobësitë në sundimin e së drejtës dhe funksionimin e dobët të institucioneve.

Integrimi i suksesshëm ekonomik në kornizat e rajonit dhe me BE-në do të mundësohet vetëm me **lidhshmërinë** e përforcuar. Shumë obligimet të marrëveshjeve rajonale ende nuk janë përmbushur. Vendet duhet plotësisht të veprojnë në pajtim me Marrëveshjen për Komunitetin Energjetik dhe Marrëveshjen për Komunitetin Transportues dhe rregullat e BE-së që janë relevante për sferën e përbashkët evropiane të aviacionit, me të cilat janë obliguar ta miratojnë ligjvënien për energjetikën dhe transportin, si dhe standardet përkatëse (p.sh.: mjedisi jetësor dhe konkurrenca) me kohë para aderimit.

Rajoni duhet të sigurojë se marrëveshjet dhe angazhimet ekzistuese do të fillojnë të funksionojnë, për shembull në kontekst të Marrëveshjes për Tregtinë e Lirë të Evropës Qendrore që duhet të reformohet që më mirë t'u përgjigjet nevojave të rajonit. Miratimi i planit shumëvjeçar të veprimit për zhvillimin e Sferës Ekonomike Rajonale e kontraktuar nga liderët e Ballkanit Perëndimor në korrik 2017 është premtues: zbatimi i tij më tutje do ta përforcojë tregtinë, investimin dhe mobilitetin në kornizat e rajonit dhe ndërmjet rajonit dhe BE-së. Do të ndihmojë të integrohen tregjet në zinxhirët e vlerës evropiane dhe globale dhe do të përparohet digjitalizimi i ekonomive në rajon. Do të ndihmojë edhe të përshpejtohet zhvillimi i ndërmarrjeve dhe shkathëtsive, hulumtimit dhe novacioneve dhe rritja e mençur.

3. Zbatimi i rregullave dhe standardevë të BE-së

Çështjet esenciale si sundimi i së drejtës, të drejtat fundamentale, përforcimi i institucioneve demokratike, reforma e administratës publike, si dhe zhvillimi ekonomik dhe konkurrenca edhe më tutje janë prioritetet kryesore në procesin e zgjerimit. Këto e formojnë bazën për secilin vend-aspirant të sigurojë se e ka kapacitetin e domosdoshëm administrativ dhe gjyqësor që me rregull t'i zbatojë rregullat dhe standardet jo vetëm në ligj, por edhe në praktikë.

Mbetet punë e madhe për harmonizimin me të drejtën e BE-së, për vendosjen apo mbindërtimin e institucioneve përkatëse dhe sigurimin e kapacitetit për zbatim, pa marrë parasysh nëse është në lidhje me rregullat e tregut unik, politikës sociale, legjislacionit për energjetikë dhe transport apo të drejtën evropiane për mjedisin jetësor.

Zbatimi i obligimeve që dalin nga marrëveshjet për stabilizim dhe asocim dhe marrëveshjet tjera sektoriale do t'i mbështesë përgatitjet për përmbushjen e kërkesave për anëtarësim në BE. Duhet plotësisht të shfrytëzohet ndihma teknike e arritshme me mbështetjen për ndërtimin e institucioneve përmes Instrumentit për Ndihmë Teknike dhe shkëmbimit të informatave.

4. Pajtimi, marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal – parakushtet për aderim

Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore janë esenciale për përparimin e rrugës evropiane të secilit vend. Krahas nismave rajonale ekzistuese si Këshilli për Bashkëpunim

Rajonal, formatet për bashkëpunimin politik deri te niveli më i lartë të nxitura nga rajoni dhe samitet e paradokohshme krijuan një moment të ri. Kjo duhet në mënyrë plotësuese të shfrytëzohet që të vazhdohet të kontribuojë në stabilizimin politik dhe të krijohen mundësitë ekonomike.

Së bashku me bashkëpunimin e përmirësuar rajonal, me rëndësi esenciale janë përpjekjet e mëtutjeshme në pajtimin që fuqishëm të prezantohet paqja dhe të garantohet stabiliteti i përhershëm në rajon. Plagëve të nëntëdhjeta ende u duhet kohë të shërohen. Por, pas 25 vitesh, është koha të përgjigjet në pyetjet e hapura me energjinë e re. Të gjitha vendet duhet pazezervë të angazhohen edhe me fjalë, edhe me vepra, që ta **tejkalojnë trashëgminë** nga e kaluara, duke arritur pajtimin dhe duke i zgjidhur çështjet e hapura me kohë para aderimit të tyre në BE.

Bashkëpunimi rajonal, marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe pajtimi nuk mund të imponohen prej jashtë. Liderët e rajonit **duhet të marrin pronësi të plotë** dhe të bëhen shembull. Duhet t'u shmangen dhe t'i gjykojnë deklaratat apo veprimet të cilat do të nxitnin tension ndëretnik dhe në mënyrë aktive ta kundërshtojnë retorikën nacionalistike. Në BE nuk ka vend për retorikën që përhapet, veçanërisht jo për lartësimin e kriminelëve të luftës në cilëndo anë. Procesi i **drejtësisë tranzicione** nuk është i plotë. Çështjet e pazgjidhura senzitive si ballafaqimi me rastet e kriminelëve të luftës duke e përfshirë bashkëpunimin e plotë me Mekanizimin për tribunalet penale ndërkombëtare dhe odat specialistike për Kosovën, fatin e personave të zhdukur, refugjatëve dhe personave të brendshëm të shpërngulur, si dhe gjetjen dhe mënjanimin e minave të mbetura të pashkelura në rajon, duhet urgjentisht të zgjidhen.

Rolit të **arsimit** duhet t'i jepet prioritet më i lartë, veçanërisht në kuptimin e nxitjes së tolerancës së madhe, promovimit të vlerave evropiane dhe përforcimin e kohezionit në shoqëri. Ballkani Perëndimor duhet të investojë më tepër në gjeneratat e reja, qytetarët tanë të ardhshëm evropianë dhe t'u jepet perspektivë në të ardhmen, e jo në të kaluarën. Gjithashtu, duhet të përforcohet bashkëpunimi në sferën e **kulturës** me dhe në kornizat e rajonit.

Politika e zgjerimit të BE-së duhet të vazhdojë të eksportojë stabilitet. Andaj BE-ja nuk guxon dhe nuk do të importojë **konteste bilaterale**. Këto duhet të zgjidhen si çështje urgjente nga palët përgjegjëse. Arritja e këtij qëllimi do të lehtësohet me atmosferën e marrëdhënive të mira fqinjësore, por gjithashtu do të jetë edhe testi i lakmusit për atë se sa janë stabile këto marrëdhënie. Nëse kontestet kufitare nuk zgjidhen në mënyrë bilaterale, palët duhet pa kusht t'i japin në **arbitrazhin ndërkombëtar përfundimtar dhe obligues**, aktgjykimet e të cilit duhet plotësisht të zbatohen dhe të respektohen nga të dyja palët para aderimit dhe duhet të merren parasysh gjatë përgatitjes së marrëveshjeve për aderim. Komisioni do t'i kushtojë vëmendje procesit të zgjidhjes së këtyre kontesteve dhe do të sigurojë mbështetjen në mënyrë përkatëse. Të gjitha vendet duhet të përmbahen nga keqpërdorimi i çështjeve të pazgjidhura gjatë procesit të aderimit në BE. Si çështje e parimit, ato që janë më përpara në rrugën evropiane kanë interes strategjik të jenë ithtarë, e jo prishës të aspiratave të fqinjëve të tyre. Vendet në rajon janë të varura në mënyrë të ndërsjellë dhe do të përparojnë më shpejtë nëse ndihmohen njëri me tjetrin në proces.

Pa normalizimin efektiv dhe gjithëpërfshirës të marrëdhënive Beograd – Prishtinë përmes dialogut të lehtësuar nga BE-ja nuk duhet të ketë stabilitet të përhershëm në rajon. Marrëveshja obliguese dhe juridike gjithëpërfshirëse për normalizim është urgjent dhe crucial për Serbinë dhe Kosovën të mund të përparojnë në rrugën e tyre drejt BE-së.

5. Hapat e ardhshëm në rrugën evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor

Në vitet e ardhshme të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor do të kenë mundësi të përparojnë në rrugën e tyre evropiane, në bazë të meritave të tyre dhe me shpejtësinë me të cilën do t'i arrijnë ato. Mali i Zi dhe Serbia janë udhëheqës në procesin dhe nënpjesën e ardhshme të ilustron hapat e tjera kryesore në rrugën e tyre. Shqipëria dhe Republika e Maqedonisë bëjnë përparim evident në rrugën e tyre evropiane dhe Komisioni është i gatshëm të përgatisë rekomandime për hapjen e negociatave aderuese, në bazë të kushteve të përmbushura. Komisioni do të fillojë të përgatisë Mendimin për aplikimin për anëtarësim të Bosnjë e Hercegovinës pas marrjes së përgjigjeve të plota gjithëpërfshirëse të Pyetësorit të saj. Me përpjekjen dhe angazhimin ekzistuese, Bosnjë e Hercegovina do të mund të bëhet kandidat për aderim. Kosova ka mundësi për përparimin e qëndrueshëm përmes zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim dhe të përparojë në rrugën evropiane pasi këtë do ta lejojnë rrethanat objektive. Kosova, gjithashtu, do të ketë dobi evidente të marrëveshjes përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

5.1 Ilustrimi indikativ i hapave të nevojshme për Malin e Zi dhe Serbinë ta përfundojnë procesin e aderimit në vitin perspektiv 2025

Kjo pjesë i jep hapat dhe kushtet kryesore në negociatat aderuese të nevojshme në lidhje me perspektivën e mundur 2025. Ky ilustrim është ilustrim i pastër indikativ dhe i bazuar në skenarin në rastin më të mirë. Nuk implikon automatizëm: procesi është dhe do të mbetet objektiv dhe i bazuar në merita. Shërben që të ilustron sa shpejt reformat transformuese të caktuara më lartë do të miratohen dhe zbatohen që të realizohet ky skenar. Secili vend do të vlerësohet pavarësisht sipas meritave personale në pajtim me përparimin e arritur në përmbushjen e kushteve të përcaktuara.

➤ Përfundimi i përcaktuesve të përkohshëm:

➤ Edhe fokusi më i madh i përmbushjes së **përcaktuesve të përkohshëm të sundimit të së drejtës** është me rëndësi vitale. Këto kërkesa dhe kushte janë shprehur qartë nga Komisioni në njoftimin e tij të rregullt. Liderët e vendeve tani duhet të ballafaqohen me sfidat ekzistuese në mënyrë energjike dhe me angazhime të qarta. Në rastin me Serbinë, përcaktuesit e përkohshëm lidhur me normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën (Kapitulli 35) duhet të përmbushen dhe urgjentisht duhet të lidhet marrëveshja obliguese dhe juridike gjithëpërfshirëse për normalizim.

➤ Përkufizimi i pozicioneve të përbashkëta të BE-së në politikat kryesore:

Komisioni do të përgatisë Komunikimin me **vlerësimet e efektit të aderimit të ardhshëm** në politikat kryesore siç janë bujqësia, politika e kohezionit dhe buxheti. Kjo do t'u ndihmojë vendeve-anëtare t'i përkufizojnë pozicionet e përbashkëta të BE-së për negociatat në kapitujt relevantë me mirëkuptimin e plotë për ndikimin e mundur, si dhe të përkufizohen masat kalimtare. Zbatimi i parimit të lëvizjes së lirë të punëtorëve në vendet e reja anëtare është çështje që njëjtë i shqetëson qytetarët e BE-së dhe Ballkanin Perëndimor. Si rrjedhojë, natyra e masave kalimtare në këtë sferë duhet të zgjidhet në procesin e negociatave. Në rastin e Serbisë, zbatimi i marrëveshjes obliguese dhe juridike gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën duhet të përparojë.

➤ Mbyllja e negociatave:

Pasi të përmbushen të gjitha përcaktuesit përfundimtarë për të gjithë kapitujt, duke e përfshirë edhe evidencën kredibile dhe të qëndrueshme për zbatimin e reformave, veçanërisht për sundimin e së drejtës, vendet-anëtare do të jenë në pozitën të pajtohen për **mbylljen e negociatave gjithëpërfshirëse** në konferencën ndërqeveritare. Ky do të jetë përparim i vazhdueshëm i pakthyeshëm në agjendën e reformave. Në rastin e Serbisë duhet të arrihet

zbatimi i pakthyeshëm i marrëveshjes obliguese dhe juridike gjithëpërfshirëse me Kosovën që do ta pasqyrojë konsolidimin e normalizimit të plotë të marrëdhënieve.

➤ **Nënshkrimi i Marrëveshjes për Aderim:**

Pasi vendi apo vendet do t'i përfundojnë negociatat, **Marrëveshja për Aderim** duhet të nënshkruhet, pas mendimit të Komisionit, pëlqimit të Parlamentit Evropian dhe vendimit të Këshillit për pranimin e vendeve të reja anëtare.

➤ **Aderimi:**

Pasi do të përfundojë ratifikimi i Marrëveshjes për Aderim në të gjitha vendet-anëtare të BE-së dhe në vendin-aderues apo vendet-aderuese, duke i pasur parasysh kërkesat kushtetuese kombëtare, **atëherë duhet të ndodh aderimi.**

II.PERSPEKTIVA KREDIBILE E ZGJERIMIT – KËRKON MBËSHTETJEN NGA BASHKIMI EVROPIAN

Perspektiva e zgjerimit të Ballkanit Perëndimor është e para dhe para se gjithash në duart e atyre vendeve, BE-ja duhet të mbetet kredibile, stabile dhe e drejtë, duke i përmirësuar politikat e veta që më mirë ta mbështesë procesin e transformimit në rajon. Dhe duhet t'i përmbush angazhimet e veta sikur që Ballkani Perëndimor i përmbush angazhimet e tij – në interesin strategjik të Evropës.

Pjesa më poshtë, së bashku me planin e veprimit në aneks, cakton një varg nismash kryesore që paraqesin përforcim evident të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor, që është interes i përbashkët. Këto nisma do të kërkojnë mbështetje konkrete nga institucionet evropiane, si dhe nga vendet-anëtare të BE-së.

Politika e zgjerimit të BE-së dhe procesit të stabilizimit dhe asocimit dhe veglat dhe instrumentet që i sigurojnë këto edhe më tutje mbetet themeli i mbështetjes së saj të Ballkanit Perëndimor. Komisioni do të përpiqet të sigurojë koordinim të përforcuar në të gjitha aktivitetet relevante, gjithashtu edhe me pjesëmarrësit tjerë, duke i përfshirë institucionet financiare ndërkombëtare, edhe më tutje do ta përparojë pronësinë rajonale që është cruciale që të përparojë rajoni.

BE-ja duhet ta përforcojë angazhimin në politikat me Ballkanin Perëndimor, duke u fokusuar në sferat me interes të përbashkët siç janë drejtësia dhe punët e brendshme, duke e përfshirë sigurinë dhe luftën kundër krimit të organizuar, ekonominë dhe tregun unik, energjetikën, transportin dhe politikën digjitale, politikën sociale, arsimin, hulumtimin dhe inovacionet, si dhe punët e jashtme dhe mbrojtjen.

Bashkëpunimi në këto sfera do të mbështetet me pjesëmarrjen e rritur të Ballkanit Perëndimor në **këshillat joformalë**, si dhe **kontaktet e rregullta në nivel ministror**. Komisioni, nga ana e vet, në mënyrë përkatëse do ta përfshijë Ballkanin Perëndimor në **komunitetet teknike dhe grupet e punës së Komisionit**. Pas samitit për Ballkanin Perëndimor në Sofje në maj 2018, liderët e BE-së duhet të vazhdojnë të punojnë me kolegët e tyre të Ballkani Perëndimor, duke e përfshirë edhe në nivel të samitit.

Politikat e brendshme relevante të BE-së dhe programet për financim duhet në mënyrë të mëtejshme të zgjerohen në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe duhet t'u sigurohet mbështetja, që të mund më mirë ta shfrytëzojnë pjesëmarrjen e përhershme në këto programe dhe rrjete të BE-së.

Komisioni do ta përforcojë ndihmën teknike për Ballkanin Perëndimor që t'u ndihmojë në

harmonizimin me legjislacionin e BE-së dhe të sigurohet zbatimi efektiv në praktikë. Shkëmbimi me **administratat** në rajon, gjithashtu, do të përforcohen dhe **formatet njerëz me njerëz** në mënyrë plotësuese do të lehtësohen si partnerë lokalë ndërmjet komunave nëpër rajonin me këto në vendet e BE-së.

Që të vazhdohet interesi ynë reciprok për përforcimin e sigurisë sonë, dialogjet e strukturuar për politikën e përbashkët të sigurisë dhe të jashtme / politika e përbashkët e sigurisë dhe e jashtme duhet të zgjerohen dhe thellohen me pjesëmarrjen e rritur në misionet dhe operacionet e BE-së nëpër botë me partnerët individualë në mënyrë përkatëse, si dhe me zhvillimin e mëtejshëm të pjesëmarrjes në aksionet lidhur me kërcënimet hibride, zbulimin, çështjet kozmike dhe reforma e sektorit të mbrojtjes dhe të sigurisë. Në këtë kontekst, vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të përshpejtojnë dhe harmonizimi i tyre me pozicionet e BE-së në politikën e jashtme, duke i përfshirë masat restriktive. Aderimi në BE është zgjedhja dhe kërkon ndarjen e parimeve, vlerave dhe qëllimeve që Bashkimi Evropian tenton t'i promovojë në fqinjësinë e saj dhe më larg, duke e përfshirë harmonizimin e plotë me politikën e përbashkët të sigurisë dhe të jashtme.

1. Mbështetja e përforcuar për sundimin e së drejtës

Duhet të përforcohen angazhimet që të mbahen reformat lidhur me sundimin e së drejtës në rajon, që të mbështeten hapat ambiciozë që do t'i marrin këto vende. Veglat e zhvilluara gjatë kohës së negociatave me Malin e Zi dhe Serbonë në kornizat e kapitujt për sundimin e së drejtës duhet të shfrytëzohen edhe në vendet tjera të Ballkanit Perëndimor si nxitje për miratimin e hershëm të reformave kryesore. Kjo do ta përfshijë analizën e legjislacionit dhe praktikën në këtë sferë, që do të shpie në **përcaktimin e planeve të hollësishme të veprimit** në të cilat do të jepet prioritet në çështjet kryesore dhe prej afër do të ndiqet zbatimi dhe dërgimi i rezultateve konkrete.

Ka përfitim të madh nga kontributet e zmadhuara të vendeve anëtare dhe ekspertëve në mbështetjen dhe presionin për të vazhduar me realizimin e reformave. Duhet të bëhen vlerësime më të detajuara të sundimit të së drejtës dhe **misionet këshillimore duhet të zgjerohen në gjithë Ballkanin Perëndimor**, duke u ndërtuar mbi përvojën e misioneve këshillimore paraprake. Ndjekja e realizimit dhe zbatimit duhet të përforcohet përfshirë edhe përmes misioneve vlerësuese më sistematike të bazuara në rast të organizuar nga Komisioni me pjesëmarrje të ekspertëve nga vendet anëtare. Duhet të futet në procesin e gjyqimit në sferën e korrupsionit serioz dhe krimin të organizuar. Do të zhvillohen indikatorë për ndjekje të realizimit të reformave: Progresi në reformën gjyqësore duhet të matet me efektivitetin e drejtësisë të cilën sistemi mund ta sigurojë për qytetarët e tij dhe komunitetin afarist.

Kornizat për negociata të vendosura për Malin e Zi dhe Serbinë veçanërisht e theksojnë nevojën për t'u fokusuar në reformat e sundimit të së drejtës herët në negociata. Komisioni rekomandon **shfrytëzueshmëri më të madhe të instrumenteve të siguruara në kornizë të negociatave**. Sipas kësaj, duhet të kërkohet përmirësim i konsiderueshëm në sundimin e së drejtës dhe veçanërisht rezultate konkrete në reformën gjyqësore dhe në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar para se të mbyllen përkohësisht bisedimet teknike për kapitujt tjera të negociatave aderuese.

- Komisioni do t'i përfshijë këto aktivitete në kuadër të nismës kryesore për **përforcimin e sundimit të së drejtës** në Ballkanin Perëndimor.

2. Përforcimi i angazhimit për siguri dhe për migracione

Bashkëpunimi i **përforcuar strategjik dhe operativ** ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në sferën e **sigurisë** përfshirë edhe përmes **agjencive relevante** është kryesore për ballafaqim efikas me kërcënimet ekzistuese të sigurisë dhe terroriste që ndikojnë në BE-në dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu duhet të përforcohet bashkëpunimi i institucioneve për zbatimin e ligjit dhe informatave në nivel kombëtar dhe rajonal ndërmjet partnerëve nga Ballkani Perëndimor.

Është bërë shumë në nivel të BE-së që të ndihmohet në ndërtimin e kapaciteteve në Ballkanin Perëndimor dhe që të lehtësohet bashkëpunimi ndërkombëtar policor dhe gjyqësor për shkak të kundërshtimit të kërcënimeve që dalin nga krimi i organizuar dhe terrorizmi, përfshirë radikalizimin që shpie në ekstremizëm të dhunshëm, sfida e luftëtarëve të huaj dhe trafikimi me armë dhe eksplozivë. Ky angazhim duhet të përforcohet më tutje në bazë të nismave të suksesshme në sferën e sigurisë dhe luftës kundër terrorizmit dhe të ndihmohet nga dialogu aktual për politikë të sigurisë ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. Partnerët e Ballkanit Perëndimor duhet – në bazë *ad-hok* – të jenë të lidhura ngushtë me diskutimet relevante që do të zhvillohen në BE në sferën e politikës së sigurisë.

Agjencitë e BE-së⁴ të mbështetura nga Interpoli, do të thirren edhe më tutje për të luajtur rol të rëndësishëm në përforcimin e bashkëpunimit strategjik dhe operativ policor dhe gjyqësor, përfshirë edhe me emërimin e oficerëve të ndërlidhjes nga Evropol në rajonin dhe me avancimin e mëtutjeshëm të Ekipeve të përbashkëta hetuese (EPH). Marrëveshjet për bashkëpunim me Evrodrejtësinë duhet të finalizohen menjëherë sapo të vendosen standardet e nevojshme për mbrojtjen e të dhënave.

Angazhimi i përforcuar **për luftë kundër terrorizmit dhe radikalizmit** duhet të përfshijë përforcim të kapaciteteve strategjike legjislative dhe institucionale në vendet-partnere, duke i mbindërtuar dialogët e përkushtuara për luftë kundër terrorizmit dhe plan veprimet e përbashkëta, dhe vazhdim të vendosjes së ekspertizës për luftë kundër terrorizmit në Ballkanin Perëndimor. Bashkëpunimi duhet të përforcohet përgjatë lidhjes së brendshme e të jashtme të sigurisë me ndihmën e agjencive të BE-së dhe Interpolit, përfshirë këmbimin e informatave për luftëtarët e huaj dhe me zgjerimin e mbështetjes së Rrjetit për vetëdijesim për radikalizëm të Ballkanit Perëndimor. Koherenca dhe sinergjia për veprim duhet të sigurohen përmes Nismës së Ballkanit Perëndimor për luftë kundër terrorizmit.

Bashkëpunimi operativ për luftë kundër llojeve të ndryshme të **krimit të organizuar** në kontekst të Ciklit të politikave duhet gjithnjë e më shumë të zmadhohet që ta përfshijë Ballkanin Perëndimor. Vëmendje të veçantë t'i kushtohet sigurimit të mbështetjes së zmadhuar për ndërtimin e kapaciteteve në sferën e **sajber-sigurisë dhe luftës kundër sajber-krimit**. Do të përforcohet bashkëpunimi me agjencitë relevante të BE-së si Evropoli dhe Agjencia Evropiane e Sigurisë dhe rrjetet dhe informatat.

Njëkohësisht, me rëndësi esenciale është që të përshpejtohet në mënyrë plotësuese bashkëpunimi strategjik dhe operativ me Ballkanin Perëndimor **për migracionin dhe menaxhimin kufitar**. Kjo përfshin sigurim të qasjes në mbrojtjen ndërkombëtare, ndarje të informatave relevante (si analiza të rrezikut), përforcim të kontrollit kufitar, sigurim të implementimit efektiv të politikave për riadmission dhe kthim dhe luftë kundër migrimit ilegal dhe kontrabandimit të emigrantëve. Gjithashtu, nevojitet përforcim i bashkëpunimit

⁴ Agjencia e Bashkimit Evropian për bashkëpunim me institucionet për zbatim të ligjit (Evropol), Agjencia evropiane për roje kufitare dhe bregdetare, Njësia për bashkëpunim gjyqësor e Bashkimit Evropian (Evrodrejtësi), Agjencia e Bashkimit Evropian për trajnime për zbatimin e ligjit (Cepol)

ndërkombëtar dhe rajonal (përfshirë me agjencitë e BE-së⁵ dhe oficerët adekuat të ndërlidhjes në rajonin) dhe konsolidim i mëtutjeshëm i kapaciteteve për menaxhim me kufijtë dhe migracionin.

Që këtu, Komisioni propozon të vazhdojë procesin e lidhjes së marrëveshjeve të statusit të Rojës kufitare dhe bregdetare evropiane me partnerët e Ballkanit Perëndimor, duke siguruar kornizë të qartë juridike dhe mekanizma mbrojtëse për bashkëpunim operativ më të afërt. Kjo duhet ta përfshijë mundësinë për vendosje dhe realizim të aktiviteteve të përbashkëta operative të organeve kombëtare kompetente të vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor bashkë me Agjencinë e Rojës kufitare dhe bregdetare evropiane. Thellimi i bashkëpunimit rajonal dhe përforcimi i këmbimit të informatave ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në këtë sferë do të jenë kenë rëndësi të barabartë.

Për t'u përgjigjur aktiviteteve të ndryshme që do të ndërmerren nga ana e agjencive të BE-së lidhur me Ballkanin Perëndimor, Komisioni ka për qëllim të krijojë dhe bashkërendojë **grup punues ndër-agjenci të BE-së**, në pajtim me mandatin e tyre.

- Komisioni do t'i përfshijë këto aktivitete në kuadër të nismës kryesore për **përforcimin e angazhimit për siguri dhe migracion** në Ballkanin Perëndimor

3. Mbështetja e zhvillimit socio-ekonomik

Investimi në Ballkanin Perëndimor është investim në Evropë. Investimet do të rriten vetëm nëse përforcohet sundimi ekonomik dhe nëse realizohen reformat strukturore për rritjen e konkurrencës. Masat më poshtë shërbejnë për mbështetjen e këtij qëllimi dhe për përforcimin e rritjes dhe krijimit të vendeve të punës veçanërisht për të rinjtë në rajon. **Korniza investuese për Ballkanin Perëndimor** e financuar përmes Instrumentit për ndihmë paraaderuese gjithnjë e më shumë do të jetë strumbullari i nxitjes së investimeve në rajon. Për atë qëllim, do të zgjerohet që të tërheqë dhe bashkërendojë në mënyrë plotësuese investime nga donatorë bilateralë dhe institucione financiare ndërkombëtare. Është paraparë financim i zmadhuar në sferën e transportit, energjetikës, sektorit social, mjedisit jetësor dhe zhvillimit të sektorit publik përfshirë edhe ekonominë digjitale. Që ta ndërlidhë zhvillimin ekonomik në rajonin me prioritetet për investim të BE-së, Komisioni synon **që ta rrisë në mënyrë të konsiderueshme sigurimin e garancive** përmes Kornizës investuese për Ballkanin Perëndimor për tërheqje të investimit privat në rajon, në komplementaritet të plotë me nismat ekzistuese. Në aspekt të Kornizës financiare shumëvjeçare vijuese, Ballkani Perëndimor duhet të mbulohet në mënyrë adekuate në aranzhimin e jashtëm për kreditim.

Zona ekonomike rajonale është hap esencial për avancimin e integritimit ekonomik ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe për rritjen e atraksionit të tregut rajonal. Komisioni do të vazhdojë ta mbështesë zhvillimin e integritimit ekonomik intrarajonal, përfshirë me mobilizim të ekspertizës që të ndihmojë në realizimin e plan veprimit të Zonës ekonomike rajonale, veçanërisht në zonat e përfshirë me të drejtën e BE-së.

Megjithëse këmbimi tregtar ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor ishte mbi 34 miliardë euro në vitin 2016, ka potencial të konsiderueshëm për rritje të mëtutjeshme. Për realizimin e këtij potenciali, Komisioni **në mënyrë plotësuese do ta lehtësojë këmbimin tregtar ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor**. Kjo do të përfshijë zhvillim të programeve për njohje të ndërsjellë në bazë të Zonës për tregti të lirë në Evropën Qendrore dhe Zonës

⁵ Puna e agjencive të lartpërmendur është relevante si dhe ajo e Zyrës evropiane për mbështetje të azilit.

ekonomike rajonale (p.sh: Operatorë të autorizuar ekonomikë). Anëtarësimi në **Organizatën tregtare botërore** është parakusht për anëtarësim në BE dhe mund të nxitet rritje ekonomike dhe investim i konsiderueshëm për rajonin. Komisioni do të vazhdojë t'i ndihmojë Bosnjë e Hercegovinës dhe Serbisë në procesin e tyre të aderimit në Organizatën tregtare botërore.

Zhvillimi i **sektorit të fuqishëm privat i udhëhequr nga sipërmarrës dhe nga rajoni dhe nga BE-ja** do ta shfrytëzojë më mirë energjinë e **rinisë** nga rajoni dhe do të nxisë integrim ekonomik në dobi të ndërsjellë. Lidhjet ndërmjet komunitetit afarist të diasporës në BE dhe sipërmarrësve në BE dhe Ballkanit Perëndimor do të jenë edhe më tutje inkurajuese përfshirë edhe përmes programit të BE-së për Konkurrencë të ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Nevojiten masa për zmadhim të qasjes në financa dhe për shfrytëzim të potencialit për rritje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Që të përforcohen sipërmarrësia dhe inovacionet, Komisioni do të zhvillojë program për mbështetje të transferimit të teknologjisë dhe **bizneseve fillestare** nëpër rajonin dhe do t'i mbështesë përpjekjet e orientuara drejt specializimit të mençur, si dhe ekonomisë qarkulluese. Programet kornizë të BE-së janë tashmë të hapura për Ballkanin Perëndimor. Që të sigurohet pjesëmarrja e tyre më efikase, duhet të parashihet integrim i mëtutjeshëm në rrjetet ekzistuese të njohurisë në BE, përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve për hulumtim dhe novacione. Bashkëpunimi mund të avancohet në mënyrë plotësuese përmes nismave tjera, përfshirë strategjitë makrorajonale të BE-së.

Komisioni do të punojë në mbështetjen e profesionalizmit dhe pavarësisë së atyre nëpunësve që punojnë në **furnizimet publike** dhe në përforcimin e mekanizmave për mbikëqyrje që të mundësohet ndjekja e gjithë ciklit të tenderit. Në mënyrë që të jenë efikase këto përpjekje, nevojitet një angazhim i fortë politik për ballafaqim me korrupsionin.

Procesi i **programit vjetor për reforma ekonomike** i udhëhequr nga Komisioni me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor është vegël kryesore për mbështetje të modernizimit të ekonomive të tyre, dhe për arritje të bashkërendimit më të afërt ekonomik me BE-në. Komisioni do ta përforcojë këtë proces dhe do ta përafrojë ende më shumë me semestrin evropian për vende anëtare të BE-së dhe do të sigurojë ndihmë më të avancuar teknik.

Shtylla evropiane e të drejtave sociale i reflekton principet dhe të drejtat që janë esenciale për tregjet e drejta dhe funksionale të punës dhe sistemet e mbrojtjes sociale. Përmes **dimensionit të ri të përforcuar social për Ballkanin Perëndimor**, Komisioni do të punojë që ta mbështesë politikën e punësimit dhe politikën sociale në rajon, duke nxitur angazhim adekuat nga të gjitha nivelet e pushtetit, partnerë socialë dhe shoqëri civile. Kjo do të përfshirë fokus të zmadhuar në reformat e punësimit dhe reformat sociale përmes ndjekjes së zmadhuar të politikave relevante, përfshirë në kontekstin e programeve për reformë ekonomike. Komisioni propozon takim ministror vjetor ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor për çështje sociale dhe çështje nga sfera e punësimit për shkak të këmbimit të pikëpamjeve. Duhet të parashihet ndihmë më e madhe financiare në sektorin social, veçanërisht investim në arsimin dhe shëndetësinë që të mbështetet përfshirja sociale.

Duhet të sigurohet mbështetje e përforcuar për arsimin veçanërisht **për arsimin profesional dhe trajnimin dhe shkathhtësitë** si dhe trajnimin e mësuesve dhe arsimin parashkollor. **Financimi sipas programit Erasmus+ do të dyfishohet** në mënyrë që të ofrohet ndihmë që ende më shumë qytetarë të rinj të Ballkanit Perëndimor të mësojnë dhe të fitojnë përvojë në BE, në atë mënyrë duke e avancuar zhvillimin ekonomik dhe duke promovuar vlera të përbashkëta. Do të vendoset pilot program për mobilitet për nxënësit dhe trajnuesit për arsim dhe trajnim profesional, në bashkëpunim të ngushtë me palët e prekur përfshirë edhe

Fondacionin evropian për trajnim.

- Komisioni do t'i përfshijë këto aktivitete në kuadër të nismës kryesore për **mbështetje të zhvillimit socio-ekonomik** në Ballkanin Perëndimor.

4. Rritja e lidhshmërisë

Rrita e lidhshmërisë në Ballkanin Perëndimor paraqet interes strategjik për të dyja palët. Lidhjet e zmadhuara të transportit dhe energjetikës do të mundësojnë konkurrencë të zmadhuar, rritje ekonomike dhe siguri të furnizimit, dhe njëkohësisht janë parakusht i rëndësishëm për integrimin ekonomik në kuadër të Ballkanit Perëndimor. Marrëveshja për komunitetin energjetik dhe Marrëveshja për komunitetin transportues si dhe Zona e përbashkët evropiane e aviacionit sigurojnë korniza të avancuara rregullatore që – në kombinim me bashkëpunimin e fuqishëm politik në rajon – mund në masë të madhe ta lehtësojnë lidhshmërinë në rajon.

Gjeografikisht, Ballkani Perëndimor është i rrethuar me vende anëtare të BE-së dhe është prioritet politik **lidhja e infrastrukturës, gjithashtu, ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor** dhe të përshpejtohet zhvillimi i rrjeteve trans-evropiane të ndërlidhura reciprokisht në sferën e transportit, energjetikës dhe shërbimeve digjitale. Investimi në rrjete infrastrukturore sjell përfitime të dukshme të pranuar qartë nga qytetarët dhe komuniteti afarist i BE-së si dhe i Ballkanit Perëndimor. Krahas financimit të zmadhuar të këtyre rrjeteve dhe krijimit të skemës së re garantuese për investim privat, Komisioni do të punojë që të sigurojë përdorim më efikas të dispozitave ekzistuese nga **Mekanizmi për lidhjen e Evropës** për vendet nga Ballkani Perëndimor. Komisioni do t'i hulumtojë mundësitë për thjeshtimin e pjesëmarrjes së tyre në Kornizën e ardhshme financiare shumëvjeçare.

Komuniteti Energjetik me Ballkanin Perëndimor. Që të përforcohet **Komuniteti Energjetik i BE-së, të gjitha dimensionet e tij** duhet të zgjerohen në Ballkanin Perëndimor: mbështetje të sigurisë energjetike, integritetit tregtar dhe tranzicionit energjetik, përfshirë efikasitetin energjetik dhe energjitë e përsëritshme. Në atë kontekst, çdo vend duhet t'i përfundojë të gjitha reformat e nevojshme dhe plotësisht t'i orientojë politikat e veta në pajtim me pesë shtyllat e Komunitetit energjetik. Ndërtimi i kapaciteteve të **rregullatorëve energjetikë dhe operatorëve të sistemeve bartëse** në Ballkanin Perëndimor duhet të mbështetet në mënyrë që ato të mund të marrin pjesë tërësisht në rrjetet në nivel të BE-së. Duhet të vazhdojë puna për përfundimin e **Tregut rajonal të energjisë elektrike** në Ballkanin Perëndimor dhe të sigurohet integrimi i tij në Tregun e brendshëm të energjisë elektronike të BE-së.

Drejt Komunitetit të vërtetë transportues me Ballkanin Perëndimor: zbatimi i Marrëveshjes për komunitetin transportues e cila hyri në fuqi në vitin 2017 do të jetë hapi kryesor i cili do të shpjerë në integrimin progresiv të rajonit në tregun transportues të BE-së. Tashmë janë definuar marrëveshjet për korridoret transportuese prioritare ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor si pjesë e rrjetit transportues transevropian. Ato tani duhet të bëhen realitet që të garantohet kontributi i tyre në rritjen e konkurrencës në kontinentin në tërësi. Krahas investimit, prioritet është harmonizimi me standardet operative të BE-së. Kjo – në mesin e reformave tjera kryesore – do të kërkojë masa të përforcuara që të mënjanohen **pengesat administrative dhe pengesat e kufijve** në aspekt të avancimeve të operacioneve të integruara rrugore dhe hekurudhore. Nevojitet **një strategji e re për hekurudha** që të inkuadrohet Ballkani Perëndimor në rrjetin kryesor dhe tregun e BE-së dhe të promovohet hapja e tregut hekurudhor rajonal. Përveç kësaj, do të nevojiten përpjekje të targetuara që të zvogëlohet numri i lartë joproporcional i viktimitave në rrugët përmes **strategjisë së re për**

siguri në rrugët.

- Komisioni do t'i përfshijë këto aktivitete në kuadër të nismës kryesore për **mbështetje të lidhshmërisë** së Ballkanit Perëndimor.

5. Lansimi i Agjendës digjitale për Ballkanin Perëndimor

Zhvillimi i **Tregut të vetëm digjital të BE-së** kontribuon për zhvillim të biznesit, krijim të rritjes, nxitje të produktivitetit, promovim të novacionit, transformim të shërbimeve publike dhe përmirësim të cilësisë së jetës së qytetarëve. Me rëndësi kryesore është që Ballkani Perëndimor të jetë i përfshirë në përpjekjet e BE-së që të pranohet ndryshimi teknologjik që të mund të kenë dobi nga veglat digjitale, dhe të sigurohet ardhmëri e qëndrueshme dhe prosperitare për qytetarët e tyre.

Bashkërisht me partnerët e Ballkanit Perëndimor, Komisioni do të lansojë **Agjendë digjitale për Ballkanin Perëndimor**, e cila do të përfshijë edhe udhërrëfyes për lehtësimin e uljes së çmimit të **roamingut**. Do të sigurohet mbështetje për vendosjen e internetit me brez të gjerë në kuadër të Ballkanit Perëndimor dhe me BE-në. **Shoqëria digjitale** duhet të zhvillohet dhe për të njëjtën do të sigurohet ndihmë, veçanërisht për shërbimet në e-qeverinë dhe e-shëndetësinë, si dhe për zhvillim të **shkathtësive digjitale**. Komisioni do ta mbështesë ndërtimin e kapaciteteve për **besim dhe siguri** dhe **për digjitalizim të industrisë** në Ballkanin Perëndimor që të sigurojë se të gjithë sektorët kanë dobi nga inovacionet digjitale. Këto përpjekje do të plotësohen me mbështetjen e përfunduar për miratim, zbatim dhe realizim të **së drejtës së BE-së** në sferën e tregut të vetëm digjital.

- Komisioni do t'i përfshijë këto aktivitete në kuadër të nismës kryesore për **Agjendën digjitale** për Ballkanin Perëndimor.

6. Mbështetja për pajtim dhe marrëdhëniet e mira miqësore

Nxitja e marrëdhënieve të mira miqësore dhe pajtimi ka nevojë për ndjenjë të fuqishme të pronësisë në Ballkanin Perëndimor dhe të njëjtat duhet të udhëhiqen para së gjithash nga vendet e rajonit. Duhet edhe më tutje të përfordohen marrëdhëniet e mira fqinjësore përmes nismave për bashkëpunim rajonal. Komisioni është i përgatitur që të vazhdojë mbështetjen e këtij bashkëpunimi, përmes agjendës për lidhje, përmes formatit 6-shi i BP dhe përmes nismave që i bashkojnë shefat e shteteve dhe qeverive nga rajoni ose përmes nismave tjera që e përfordojnë pronësinë e tyre të bashkëpunimit rajonal.

Komisioni në mënyrë plotësuese do ta zgjerojë mbështetjen për nismat për pajtim, përfshirë edhe për ato të cilat kanë të bëjnë me **drejtësinë tranzicionale** dhe kanë për qëllim ta tejkalojnë trashëgiminë nga konflikti i paradokohshëm. Do të vazhdojë mbështetja për Mekanizmin për tribunalet penale ndërkombëtare dhe për Odat specialiste për Kosovën. Komisioni gjithashtu do të shqyrtojë se si mund të avancohet më së miri puna e Komitetit Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq dhe Komisionit Ndërkombëtar për personat e zhdukur që të nxitet bashkëpunimi rajonal dhe të zgjidhet çështja për personat e zhdukur dhe do të bëhen analiza se çfarë mund të bëhet më shumë në mënyrë që të zvogëlohet rreziku nga minat tokësore.

Mbështetja për arsimin dhe potenciali i të rinjve në Ballkanin është me rëndësi kryesore për zhvillimin e mëtutjeshëm të rajonit dhe parakusht për bashkëjetesë të qetë dhe pajtim. Krahas arsimit, do të rritet bashkëpunimi edhe në sferën e **kulturës, të rinjve dhe sportit**. Do të zgjerohet përfshirja dhe shtrirja e **Zyrës rajonale për bashkëpunim të të rinjve**. Krahas rritjes

së mbështetjes financiare përmes Erasmus+, Komisioni do të vazhdojë t'i nxisë lidhjet kulturore me rajonin. Kjo do të përfshijë aktivitete për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të Ballkanit Perëndimor dhe avancimin e industrive të tij kulturore dhe kreative.

- Komisioni do t'i përfshijë këto aktivitete në kuadër të nismës kryesore për **mbështetje të pajtimit dhe marrëdhënies të mira fqinjësore** në Ballkanin Perëndimor.

III. PËRGATITJA E BE-SË PËR PRANIM TË ANËTARËVE TË RINJ

1. Çështja institucionale

Vetë BE-ja doemos duhet të sigurojë se do të përgatitet institucionalisht për pranim të vendeve të reja anëtare sapo t'i përmbushin ato kushtet e vendosura. **BE-ja doemos duhet të jetë më e fuqishme dhe më e qëndrueshme para se të bëhet më e madhe.**

Përdorimi i votimit me shumicë të kualifikuar në Këshillin është vegël kryesore e cila mundëson të miratohen vendimet e nevojshme në BE-në nga 27 vendet anëtare. Që të sigurohet vendimmarrja efikase, do të jetë e nevojshme që politika të caktuara së paku të ruhen si sfera për të cilat do të votohet me shumicë të kualifikuar në Këshillin. Komisioni do të miratojë Komunikim për mundësinë për përmirësim të mëtutjeshëm të shfrytëzimit të votimit me shumicë të kualifikuar në tremujorin e tretë nga viti 2018.

Të jesh anëtar i BE-së do të thotë të pranosh dhe t'i promovosh vlerat e saj. Kur mendohet për të ardhmen e BE-së, duhet të vendoset mekanizëm më efikas i cili do të sigurojë të ndërmerren masa efektive për ballafaqim me kërcënimin sistemor ose shkeljen sistemor të këtyre vlerave nga ana e cilitdo vend anëtar të BE-së. Komisioni do të prezantojë iniciativa për përforcimin e zbatimit të sundimit të së drejtës në Bashkimin Evropian në tetor 2018. Marrëveshjet për aderim mund të sigurojnë bazë juridike që të vendoset mekanizëm në kuadër të Marrëveshjeve.

Aderimi i vendeve nga Ballkani Perëndimor **do të ndikojë në aranzhimet institucionale ekzistuese në BE.** Propozime për zgjidhjen e këtyre çështjeve institucionale do të nevojiten para mbylljes së negociatave. Kur do të shqyrtohen aranzhimet institucionale për zgjerimin e ardhshëm, duhet të mbahet konsideratë për anëtarësimin e ardhshëm të vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor. Konkretisht, përdorimi i votimit me shumicë të kualifikuar në Këshillin është vegël kryesore që mundëson të miratohen vendime të nevojshme në Bashkimin Evropian nga 27.

Gjithashtu, doemos duhet të vendosen aranzhime të veçanta dhe **obligime të parevokueshme** që të sigurohet se vendet e reja anëtare nuk do të jenë mundësi për ta bllokuar aderimin e vendeve tjera kandidate nga Ballkani Perëndimor. Do të nevojiten aranzhime të veçanta në lidhje me gjuhët kombëtare të vendeve të ardhshme anëtare.

Një kohë të mjaftueshme para mbylljes së negociatave të plota aderuese, Komisioni do të japë **vlerësim për atë se si** do të ndikojë aderimi i vendeve të reja anëtare në politikat kryesore siç janë bujqësia, politika kohezive dhe buxheti. Kjo do t'u mundësojë vendeve anëtare për të definuar pozicione të përbashkëta për kapitujt adekuate me kuptim të plotë të ndikimeve të

mundshme dhe të ndërmarrin çfarëdo masa lehtësimi.

2. Sigurimi i mjeteve financiare për aderim të suksesshëm

Instrumenti për ndihmë aderuese i mbështet vendet nga Ballkani Perëndimor në përgatitjen e tyre për aderim dhe e lehtëson bashkëpunimin rajonal dhe tejkufitar. Ndërmjet vitit 2007-2017, BE-ja investoi më shumë se 8,9 miliardë euro në rajonin përmes Instrumentit për ndihmë aderuese. Për vitin 2018, janë paraparë 1.07 miliardë euro. Financimi përmes Instrumentit për ndihmë paraaderuese do të jetë ende më i përshtatur ndaj nevojave të vendeve. Zbatimi i kësaj strategjie do të kërkojë financim të zmadhuar. Që këtu, Komisioni parashihet **rritje graduale të mbështetjes nga Instrumenti për ndihmë aderuese të Ballkanit Perëndimor deri në vitin 2020** nëse lejojnë rialokimet në kuadër të pakos ekzistuese të **Instrumentit për ndihmë paraaderuese**.

Duke i pasur parasysh leksionet e mësuara nga zgjerimet paraprake, duhet të parashihet **kalim gradual dhe të përsosur** nga statusi paraaderues në status të vendit anëtar me qëllim të mundësimin të **zhvillimit të kapacitetit të nevojshë absorbues**. Kjo duhet të shpjerë në rritjen graduale të financimit në kuadër të Kornizës së re financiare shumëvjeçare të Instrumentit për ndihmë paraaderuese para aderimit, të pasuar me futje graduale në shfrytëzimin e vëllimit më të madh të fondeve pas aderimit. Kjo faktikisht do të thitë se megjithëse vendi i ri anëtar nuk mund të presë të marrë alokacion të plotë nga mjetet e BE-së menjëherë pas aderimit, qasja në fondet paraaderuese do të rritet në mënyrë të konsiderueshme dhe adekuate para aderimit.

Kushtëzimi lidhur me mbështetjen tonë bilaterale do të forcohet. Financimi i rritur edhe përmes Kornizës financiare shumëvjeçare aktuale dhe përmes Kornizës së re duhet të lidhet me progresin në realizimin e reformave fundamentale dhe marrëdhëniet të mira fqinjësore.

Duke pasur parasysh që rajoni ka një prodhim relativisht të ulët bruto dhe nivel të ulët të popullatës, pritet një ndikim shumë i kufizuar i buxhetit të BE-së nga aderimi i Ballkanit Perëndimor. Edhe krahas kësaj, zgjerimi i BE-së ka çmim dhe do të shkaktojë shpenzime të mëtutjeshme për të gjitha vendet anëtare. Korniza financiare shumëvjeçare i reflekton prioritetet politike të BE-së. Nevojat për përgatitje për aderim do të duhet doemos të merren parasysh në **Kornizën e ardhshme financiare shumëvjeçare** në të cilën do të përfshihen dispozita për zgjerim. Nëse disa kandidatë janë të përgatitur për aderim gjatë periudhës së Kornizës financiare shumëvjeçare, atëherë do të duhet të bëhen **përshtatjet e nevojshme**.

III. Komunikimi

Që të jetë i suksesshëm procesi i aderimit, për **mundësitë dhe sfidat** nga i njëjti duhet të komunikohet më qartë në rajonin dhe në BE. Në Ballkanin Perëndimor përgjegjësia është para së gjithash te qeveritë që të sigurojnë informata adekuate të qytetarëve dhe komunitetit afarist dhe të ndërtojnë konsensus nacional për qëllimin e tyre strategjik.

Nga ana e BE-së, vendet anëtare kanë për obligim t'i informojnë qytetarët e tyre dhe t'ua japin faktet e nevojshme për mundësitë dhe sfidat nga procesi. Komisioni do t'i mbështesë këto përpjekje me përforsimin e komunikimit strategjik në vendet dhe në BE me qëllim që të sigurohet shikueshmëria e procesit të zgjerimit.

IV. KONKLuzionet

BE-ja një kohë të gjatë e mbështet perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor. Ardhmëria

e rajonit si pjesë përbërëse e BE-së është interes politik, ekonomik dhe i sigurisë i BE-së. Politika e zgjerimit të BE-së është pjesë e strategjisë më të gjerë për përforcimin e BE-së deri në vitin 2025. Me vullnet të fortë politik, me reforma reale dhe të qëndrueshme dhe zgjidhje përfundimtare të kontesteve me fqinjët, Serbia dhe Mali i Zi mund të jenë të përgatitur për anëtarësim deri në këtë datë. Aderimi është dhe do të mbetet proces i bazuar në merita, tërësisht i varur nga progresi objektiv i arritur nga çdo vend.

Që të përmbushen kriteret të përcaktuara mirë për anëtarësim dhe në interes të tyre, vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të realizojnë reforma gjithëpërfshirëse në sferat kryesore. Sundimi i së drejtës, të drejtat fundamentale dhe menaxhimi doemos duhet të përforcohen në mënyrë të konsiderueshme. Reformat gjyqësore, lufta kundër korrupsionit dhe krimi i organizuar dhe reforma në administratën publike duhet të japin rezultate të vërteta dhe funksionimi i institucioneve demokratike duhet të përforcet seriozisht. Reformat ekonomike doemos duhet të realizohen në mënyrë energjike, ndërsa duhet të zgjidhen dobësitë strukturore, konkurrenca e ulët dhe papunësia e lartë.

Të gjitha vendet duhet të përkushtohen fuqimisht, me fjalë dhe vepra, në tejkalimin e asaj që është trashëguar nga e kaluara, përmes pajtimit dhe zgjidhjes së çështjeve të hapura, veçanërisht kontesteve kufitare, në kohë para aderimit të tyre në BE. Nevojitet marrëveshje gjithëpërfshirëse, juridike-obliguese për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, që të mund të avancohen në rrugën e tyre drejt BE-së.

BE-ja do ta përforcojë në mënyrë të konsiderueshme mbështetjen e saj për procesin e transformimit në Ballkanin Perëndimor. Komisioni parasheh Plan veprim për mbështetjen e transformimit të Ballkanit Perëndimor si aneks të kësaj strategjie. Në të janë përfshirë gjashtë nisma kryesore të orientuara drejt sferave kryesore me interes për BE-në dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, duke i përfshirë edhe disa masa të reja në sferat me interes të përbashkët:

Nisma për përforcimin e sundimit të së drejtës: Veglat ekzistuese për negociata siç janë plan veprimet e detajuara, do të zgjerohen në të gjitha venet e Ballkanit Perëndimor. Do të përforcet vlerësimi i implementimit të reformave, përfshirë edhe përmes misionëve të reja këshillimore në të gjitha vendet. Më shumë do të shfrytëzohen instrumentet e siguruara në kuadër të negociatave me Serbinë dhe Malin e Zi.

Nisma për përfshirje të përforcuar në sigurinë dhe migracionin: Përforcimi i bashkëpunimit për luftë kundër krimit të organizuar, luftë kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe për sigurinë e kufijve dhe për menaxhimin me migracionin. **Oficerët e ndërlidhjes të Evropolit** do të vendosen në rajonin; do të promovohen në mënyrë plotësuese **Ekipe të përbashkëta hetuese** dhe do të lidhen **marrëveshje të statusit me Agjencinë evropiane për roje kufitare dhe bregdetare.**

Nisma për përforcimin e mbështetjes së zhvillimit socio-ekonomik: do të përfshijë zgjerim të **Kornizës investuese për Ballkanin Perëndimor, rritje të konsiderueshme të sigurimit të garancive që të tërhiqen investime private,** mbështetje për biznese fillestare, dhe NVM dhe lehtësim më të madh të këmbimit tregtar. **Dimensionin e ri i përforcuar social** më shumë do të fokusohet në punësimin dhe politikën sociale, me ndihmë të zmadhuar financiare për mbështetje të sektorit social, veçanërisht arsimit dhe shëndetësisë. Financimi përmes **Erazmus+** do të dyfishohet.

Nisma për zmadhimin e lidhshmërisë transportues dhe energjetike në rajon dhe në kuadër të BE-së, përfshirë edhe **mbështetjen e re investuese**. Do të rritet përdorimi i **Mekanizmit për lidhje të Evropës** në vendet e Ballkanit Perëndimor. Që të përforcohet **Komuniteti energjetik i BE-së, të gjithë dimensionet e tij** duhet të zgjerohen në Ballkanin Perëndimor.

Nisma për Agjendën digjitale për Ballkanin Perëndimor: do të përfshijë udhërrëfyes për lehtësimin e **uljes së shpenzimeve për roaming**, mbështetje për **përdorimin e internetit me brez të gjerë** në rajon dhe zhvillim të **e-qeverisë, e-furnizimeve, e-shëndetësisë dhe shkathtësive digjitale**.

Nisma për mbështetjen e pajtimit dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore: do të përfshijë mbështetje për drejtësi tranzicionale, personat e zhdukur dhe bashkëpunim të zmadhuar në arsim, kulturë, të rinjtë dhe sport dhe zgjerim të shtrirjes së Zyrës rajonale për bashkëpunim rinor.

Në mars 2018, shërbimet e Komisionit do të caktojnë mbledhje fillestare koordinuese me vendet anëtare në koordinim të ngushtë me Shërbimin evropian për politikë të jashtme që të bisedojnë për Plan veprimin dhe mekanizmat për bashkëpunim operativ për realizimin e tij.

BE-ja duhet të jetë e përgatitur që t'i pranojë anëtarët e rinj, përfshirë edhe nga perspektiva institucionale dhe financiare, pasi ato t'i përmbushin kushtet e nevojshme. Komisioni do të përgatisë vlerësim të ndikimit në politikat kryesore në kohë para aderimit. Me qëllim të sigurimit të **financimit për mbështetje të kësaj strategjie** dhe tranzicionit të papenguar drejt anëtarësimit, Komisioni propozon **rritje graduale të financimit** në kuadër të **Instrumentit për ndihmë paraaderuese** dhe sigurim të dispozitës adekuatë në **Kornizën e ardhshme financiare shumëvjeçare** që të shërbejë aderimet e mundshme. Që të sigurojë vendimmarrje efikase, do të jetë e nevojshme së paku të mbahet ose të merret parasysh rritja e politikave për të cilat votohet me shumicë të kualifikuar në Këshill. Duhet të vendoset sistem më efikas për ballafaqim me kërcënime sistematike ose shkelje të sundimit të së drejtës në cilindo vend anëtar i BE-së. Aktivitetet komunikuese do të përforcohen.

Perspektiva evropiane e Ballkanit Perëndimor është e qartë dhe kushtet dhe kriteret për anëtarësim në BE janë mirë të përcaktuara. Përmes kësaj strategjie BE-ja do të mund të sigurojë **deri më tani mbështetje të paparë për këtë qëllim**. Vendet e prekura kanë shumë punë para vetes që të jenë në pozitë për t'i përmbushur këto kritere. Qeveritë doemos duhet të sigurojnë procese reformuese më inkluzive të cilat i përfshijnë të gjitha palët e prekura dhe shoqërinë në masë të madhe. Më e rëndësishme, liderët në rajon nuk guxojnë të lënë dyshim për orientimin dhe përkushtimin e tyre strategjik. Në fund ato doemos duhet ta ndër marrin përgjegjësinë që këtë mundësi historike ta bëjnë realitet.